



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

Nr. 1096/2 Prot.

Durrës më, 21.12. 2020

VENDIM

Nr. 10, datë 03.12. 2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR, PUS-SHPIMI PUSI
CC1, AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN
"COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA" SH.P.K PËR QËLLIME "PIJE JO
ALKOLIKE, AMBALLAZHIM SHISHE OSE ENË "

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 12, pika 1, gërma "d" të nenit 41, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre" dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për përdorimin e një pus shpimi, pusi CC1", subjektit "Coca-Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k për qëllime " pije jo alkalike, ambalazhim shishe ose enë".
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

SEKRETAR
Anastasi Meci



KRYETAR
Roland Nasto

